

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikadur®-330

RRËSHIRË EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS PËR IMPREGNIM



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikadur®-330 është rrëshirë dhe adeziv tiksotropik me bazë epokside dhe me 2 përbërës për impregnim.

PËRDORIMET

Sikadur®-330 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Sikadur®-330 përdoret si:

- Rrëshirë impregnimi për pëlhurën përforcuese SikaWrap® e aplikuar me metodën e thatë
- Rrëshirë prajmer për sistemin e aplikimit të thatë
- Adeziv strukturor për ngjitjen e petëzave Sika® CarboDur® në prerjet

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përzierje & aplikim i lehtë me mallë dhe rrul
- Prodhuar për metoda manuale saturimi
- Sjellje e shkëlqyer aplikimi mbi sipërfaqje vertikale & horizontale
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa
- Vetë mekanike të larta
- Nuk nevojitet prajmer

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtohet me LEED v4 MRc 4 (Opsioni 2): Njohja & optimizimi i produktit të ndërtimit - përbërësit e materialit
- Pajtohet me LEED v2009 IEQc 4.1: Materiale me çlirime të ulëta - adezivë & izolues

MIRATIME / STANDARDE

- Avis Technique N° 3/16-875 (annule et remplace N° 3/10-669) Sika® CarboDur®, SikaWrap®
- CIT n°290 18/07/2017 (certificato di idoneità tecnica all'impiego) ; Sika® CarboDur®, SikaWrap®, Sikadur®
- Instituti i Kërkimit për Rrugët & Urat (Poloni): IBDiM No AT/2008-03-336/1
- Adeziv për ngjitje strukturore testuar në përputhje me EN 1504-4, mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside	
Ambalazhi	5 kg (A+B)	Njësi e parapaketuar
	Ambalazh industrial:	
	Përbërësi A	kovë 24 kg
	Përbërësi B	kovë 6 kg
Ngjyra	Përbërësi A: pastë e bardhë Përbërësi B: pastë gri Përbërësit A + B të përzierë: pastë gri e lehtë	
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	

Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	1.30 ± 0.1 kg/l (përbërësit A+B të përzierë) (në +23 °C)	
Viskoziteti	Shpejtësia e prerjes: 50 /s	
	Temperatura	Viskoziteti
	+10 °C	~10 000 mPas
	+23 °C	~6 000 mPas
	+35 °C	~5 000 mPas

TË DHËNA TEKNIKE

Moduli i elasticitetit në përkulje	~ 3 800 N/mm ² (7 ditë në +23 °C)	(DIN EN 1465)		
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 30 N/mm ² (7 ditë në +23°C)	(ISO 527)		
Moduli i elasticitetit në tërheqje	~ 4 500 N/mm ² (7 ditë në +23 °C)	(ISO 527)		
Zgjatimi deri në thyerje	0.9 % (7 ditë në +23 °C)	(ISO 527)		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Dështim betoni (> 4 N/mm ²) mbi nënshtresë të përpunuar me rrymë rëre	(EN ISO 4624)		
Koeficienti i zgjerimit termik	4.5 × 10 ⁻⁵ 1/K (shkallë temperature -10 °C – +40 °C)	(EN 1770)		
Temperatura e tranzicionit të qelqit	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	TG	(EN 12614)
	30 ditë	+30 °C	+58 °C	
Temperatura e shformimit termoplastik	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	HDT	(ASTM D 648)
	7 ditë	+10 °C	+36 °C	
	7 ditë	+23 °C	+47 °C	
	7 ditë	+35 °C	+53 °C	
	Rezistencë ndaj ekspozimit të vazhdueshëm deri në +45 °C.			
Temperatura e funksionimit	-40 °C deri në +45 °C			

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Prajmer nënshtrese - Sikadur®-330. Rrëshirë për impregnim / shtrim - Sikadur®-330. Pëlhurë për përforcim strukturor - lloji SikaWrap® që përshtatet me kërkesat.
-----------------------------	--

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : përbërësi B = 4 : 1 për peshë Kur përdorni material rifuxho, raporti i saktë i përzierjes duhet të ruhet nga peshimi dhe dozimi i saktë i secilit përbërës.
Konsumimi	Shih "Method Statement për aplikimin manual të thatë të SikaWrap®" Ref 850 41 02. Udhëzim: 0.7 - 1.5 kg/m ²
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +35 °C max.
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +35 °C max.
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	< 4 % pjesë për peshë

+10 °C	~90 minuta (5 kg)	~90 minuta
+23 °C	~60 minuta (5 kg)	~60 minuta
+35 °C	~30 minuta (5 kg)	~30 minuta

Koha e punueshmërisë fillon me përzierjen e rrëshirës dhe ngurtësuesit. Është e shkurtër në temperaturë të lartë dhe e gjatë në temperatura të ulëta. Sa më e madhe të jetë sasia e materialit të përzierë, aq më e shkurtër është koha e tij e punueshmërisë. Për të përfutur punueshmëri më të gjatë në temperatura të larta, adevizi i përzierë mund të ndahet në pjesë. Një metodë tjetër është ftojja e përbërësve A+B përpara përzierjes së tyre (jo nën +5°C).

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj tërheqjes për të ofruar rezistencë minimale ndaj tërheqjes 1.0 N/mm² ose aq sa kërkesat e specifikimit të projektimit.

Shih gjithashtu "Method Statement për aplikimin manual të thatë të SikaWrap®" Ref 850 41 02.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Shih "Method Statement për aplikimin manual të thatë të SikaWrap®" Ref 850 41 02.

PËRZIERJA

Njësi të parapaketuara:

Përzieni përbërësit A+B për të paktën 3 min. me një aks përzierjeje të vendosur në mikser në shpejtësi të ulët (max. 300 rpm) derisa materiali bëhet me konsistencë të butë dhe të ketë ngjyrë gri të njëtrajtshme. Shmangni hyrjen e ajrit gjatë përzierjes. Pastaj, hidheni të gjithë përzierjen në një enë të pastër dhe përzieni sërish për ~ edhe 1 min. në shpejtësi të ulët që të minimizohet bllokimi i ajrit. Përzieni vetëm atë sasi e cila mund të përdoret brenda kohës së saj të punueshmërisë.

Ambalazh rifuxho, jo i pakeluar:

Në fillim, përzieni secilin përbërës plotësisht. Shtoni përbërësit në raportet e duhura brenda një kove dhe përzieni me një mikser në shpejtësi të ulët si më sipër.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Shih "Method Statement për aplikimin manual të thatë të SikaWrap®" Ref 850 41 02.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha pajisjet menjëherë me Sika® Colma Cleaner. Materiali i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

Sikadur®-330 duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 24 orë pas aplikimit.

Sigurohuni se vendosja e pëlurës dhe shtrimi me rul bëhet brenda kohës së punueshmërisë.

Në temperatura të ulëta dhe / ose lagështi relative të lartë, mund të formohet një mbetje e ngjithshme mbi sipërfaqen e epoksidit të tharë Sikadur®-330. Nëse do të aplikohet një shtresë pëlure ose veshjeje mbi epoksidin e tharë, kjo mbetje duhet të hiqet me ujë të ngrohtë e sapun për të siguruar ngjitjen e mjaftueshme. Në çdo rast, sipërfaqja duhet të jetë e thatë përpara aplikimit të shtresës vijuese të veshjes. Për aplikim në kushte të ftohta ose të ngrohta, parapërgatisni materialin për 24 orë në ambient magazinimi me temperaturë të kontrolluar për të përmirësuar përzierjen, aplikimin dhe kufijtë të kohës së punueshmërisë.

Për informacione të mëtejshme rreth mbiveshjes, numrit të shtresave apo zvarrjes ju lutemi këshillohuni me një inxhinier strukturist për llogaritjet dhe shihni gjithashtu "Method Statement për aplikimin manual të thatë të SikaWrap®" Ref 850 41 02.

Rrëshirat Sikadur® janë formuluar për të patur zvarrje të ulët nën ngarkesë të përhershme. Megjithatë, për shkak të sjelljes së zvarrjes të të gjitha materialeve polimere nën ngarkesë, dizajni strukturor për ngarkesë afatgjatë duhet të përllogarisë edhe zvarrjen. Në përgjithësi, dizajni strukturor për ngarkesë afatgjatë duhet të jetë më i ulët se 20-25% e ngarkesës dështuese. Ju lutemi, konsultohuni me një inxhinier strukturist për llogaritjet e ngarkesës të aplikimit specifik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikadur®-330
Maj 2019, Botimi 03.01
020206040010000004

Sikadur-330-sq-AL-(05-2019)-3-1.pdf

